

**ARTAN R. HOXHA**

**DEMONSTRATAT NË KOSOVË NË VITIN 1981  
DHE NACIONALIZMI I REGJIMIT KOMUNIST  
TË TIRANËS – NJË ANALIZË E SHTYPIT SHQIPTAR**

**Abstrakt:**

*Kjo sprovë argumenton se në vitin 1981 u shfaq një tension ndërmjet ligjëritimit për konsum publik të autoriteteve komuniste shqiptare dhe përlllogaritjeve të tyre gjeopolitike. Për Enver Hoxhën dhe bashkëpunëtorët e tij të ngushtë, Jugosllavia përfaqësonte një shtet tampon ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të Traktatit të Varshavës. Si e tillë, ekzistenca e Jugosllavisë nuk lejonte një pushtim potencial të Shqipërisë nga Bashkimi Sovjetik dhe nga aleatët e tij, i cili do të shkaktonte ndryshimin e udhëheqjes shqiptare. Nga ana tjetër, kupola e regjimit komunist shqiptar, nuk mund të braktiste publikisht kosovarët të ngritur në protesta. Rrjedha e ngjarjeve dhe sidomos reagimi i autoriteteve të Republikës së Serbisë e zgjidhën tensionin ndërmjet nacionalizmit dhe realpolitikës. Gjatë vitit 1981, Enver Hoxha arriti në përfundimin se serbët kishin hyrë në aleancë me Moskën. Sipas udhëheqësit komunist shqiptar, nacionalizmi serb ishte shndërruar në një vjegë të politikës sovjetike në Ballkan. Nga ky moment, Hoxha mbështeti kërkesat e demonstruesve në Kosovë për shndërrimin e krahinës autonome, në një republikë të shtatë të Jugosllavisë, me qëllim që të mos lejonte forcimin e klanit serb brenda federatës dhe kështu të pengonte rritjen e ndikimit sovjetik afër kufijve të Shqipërisë.*

**Fjalë kyçe:**

Nacionalizëm, realpolitikë, Shqipëri, Kosovë, Jugosllavi, Bashkimi Sovjetik, irredentizëm.

Më 8 prill të vitit 1981, thaujse një muaj pas demonstratës së parë studentore të 11 marsit në Prishtinë, gazeta “Zëri i popullit” botoi artikullin e parë redaksional në shtypin shqiptar mbi atë që po ndodhte në

Kosovë.<sup>1</sup> Regjimi komunist i Tiranës do të qëndronte fillimisht në heshtje për atë që po zhvillohej në krahinën autonome që banohej në shumicë dërrmuese nga shqiptarë. Enver Hoxha do të mbante shënimin e tij të parë mbi lëvizjen studentore në Prishtinë vetëm në datën 1 prill, ku do të theksonte, pa bërë asnjë interpretim, dhunën e përdorur nga policia për të shpërndarë demonstratën e të rinjve si dhe parullat e tyre “Duam Kosovën të bëhet republikë”.<sup>2</sup> Përpara se sa të bënte të ditur qëndrimin e saj, Tirana zyrtare ishte në pritje të zhvillimit të mëtejshëm të ngjarjeve dhe me mjaft kujdes po përpiqej të kuptonte kush i organizonte lëvizjet studentore si dhe çfarë implikimesh do të kishin ato në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave.<sup>3</sup>

Qëndrimi i Hoxhës diktohej nga imperativa të *realpolitikës* dhe rolit që, sipas tij, luante Jugosllavia në sigurinë e Shqipërisë dhe pushtetit të tij. Fati i Jugosllavisë pas vdekjes së Titos e shqetësonte shumë Enver Hoxhën. Qysh më 13 shkurt të vitit 1980, atëherë kur Tito po lëngonte në shtratin e tij, udhëheqësi komunist shqiptar bëri në ditarin e tij një analizë të hollësishme të situatës në Jugosllavi. Në të vërtetë, ky shënim i gjatë ishte një shkrim programatik, i zhveshur nga zhargoni marksist-leninist, ku përcaktoheshin interesat e Shqipërisë së Hoxhës lidhur me të ardhmen e Jugosllavisë post-titiste dhe pozicionin e popullsisë shqiptare në të. Teksa vëzhgonte shuarjen e jetës së armikut të tij të betuar, dora e fortë dhe mjeshtëria e të cilit kishte arritur të mbante në ekuilibër rivalitetet etnike në Jugosllavi, diktatori shqiptar ndiqte me mjaft vëmendje nga fortifikata e tij e izoluar në Tiranë atë që po ndodhte në fqinjën verior.

<sup>1</sup> Më datë 7 prill, gazeta “Shkumbini” botoi një njoftim të shkurtër mbi demonstratat studentore në Prishtinë dhe dhunën që përdorën trupat serbe për t’i shtypur ato. I njëjti artikull do të botohej të nesërmen, më 8 prill në gazetën “Zëri i rinisë” dhe më datë 9 prill në gazetën “Adriatiku”. Për më shumë, “Mbi ngjarjet në Kosovë”, *Shkumbini*, Elbasan, 7 prill 1981, f. 4; “Mbi ngjarjet në Kosovë”, *Zëri i rinisë*, Tiranë, 8 prill 1981, f. 4; “Mbi ngjarjet në Kosovë”, *Adriatiku*, Durrës, 9 prill 1981, f. 4.

<sup>2</sup> Enver Hoxha, *Ditar për çështjet ndërkombëtare (1980-1981)*, vëll. 13, Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH, Tiranë: 1985, f. 365.

<sup>3</sup> *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) Enver Hoxha, 10/AP, Grupi III, Ndarja IV, Dosja (më tej: D.) 242, fl. 14-16. Procesverbal i takimit të Enver Hoxhës, Mehmet Shehut dhe Ramiz Alisë lidhur me demonstratat në Kosovë, 3 prill 1981; *po aty*, F. Enver Hoxha, 10/AP, Grupi III, Ndarja IV, D. 243, fl. 8. Shënime nga biseda e Enver Hoxhës në Byronë Politike të KQ të PPSH-së për ngjarjet në Kosovë, 5 prill 1981.

Përmes një analize të ftohtë të raportit të forcave brenda strukturës federative jugosllave, të cilën e integroi në suazat e përplasjes Lindje-Perëndim, Hoxha profetizoi shpërbërjen e mundshme të federatës. Sipas tij, shembja do të ishte rezultat i ndërthurjes së shkaqeve të jashtme, që ai i identifikonte me rivalitetin amerikano-sovjetik për të zgjeruar sferën e tyre të influencës, dhe faktorëve të brendshëm jugosllav. Rivaliteti për dominim ndërmjet klanit kroato-sllloven, që sipas Hoxhës ishte i lidhur me kapitalin perëndimor dhe kishte mbështetjen amerikane, me klanin burokratiko-centralizues serb, ishin burimi kryesor i dobësisë, që e bënë strukturën jugosllave tepër të brishtë dhe lehtësonte ndërhyrjen nga jashtë.<sup>4</sup> Ishte pikërisht frika e këtyre ndërhyrjeve, sidomos e Bashkimit Sovjetik, ajo që e shqetësonte më shumë se gjithçka liderin komunist shqiptar. Ky i fundit, identifikonte Kremlinin si rrezikun kryesor për pushtetin e tij, pasi druhej se, në rast se do të kishin mundësi sovjetikët do të ndërhynin që të ndryshonin regjimin në Shqipëri dhe të vendosnin në krye të vendit mbështetësit e tyre.

Ajo që i mbante ushtritë e Traktatit të Varshavës larg kufijve shqiptarë ishte pikërisht Jugosllavia, që për Shqipërinë e Hoxhës luante rolin e një shteti tampon. Edhe pse publikisht Enver Hoxha nuk linte rast pa anatemuar politikën e “mosangazhimit” të Titos si tradhti ndaj marksizëm-leninizmit, në ditarin e tij politik, udhëheqësi i PPSH-së rrëfente se ruajtja prej Jugosllavisë së statusit të vendit të paangazhuar kishte rëndësi jetike për të.<sup>5</sup> Kjo ishte një shtyllë e politikës së jashtme të regjimit komunist të Tiranës dhe drejtuesit e tij do ta bënë vazhdimisht të qartë se nëse Jugosllavia do të sulmohej nga një fuqi e huaj agresive, që nënkuptonte Bashkimin Sovjetik dhe aleatët e tij europianolindorë, Shqipëria do të mbështeste ushtarakisht fqinjin e saj.

Megjithatë, në vitin 1980, Hoxha ishte optimist se udhëheqja kolegjiale jugosllave do ta vazhdonte kursin e Titos. Sipas tij, edhe pse sovjetikët ishin duke përdorur pansllavizmin si instrument ideologjik për të farkëtuar aleancën në Ballkan dhe përmes tij të zgjeronin ndikimin e tyre në këtë pjesë të Europës, nuk kishin mbështetës në asnjërin prej dy klaneve kryesore në Jugosllavi, përfshi edhe serbët, të cilët ishin të interesuar të ruanin pavarësinë e tyre *vis-à-vis* të Moskës. Nga ana tjetër,

<sup>4</sup> “Panoramë e gjendjes ndërkombëtare”, në E. Hoxha, *Ditar për çështjet ndërkombëtare (1980-1981)* ..., vëll. 13, f. 44-52.

<sup>5</sup> *Po aty*, f. 50-51.

kreu i Tiranës, hidhte dyshime mbi klanin maqedonas, që, sipas tij, mbështeste politikat e aleates më besnike të Kremlinit në Ballkan, Bullgarisë, e nëpërmjet kësaj të fundit, Bashkimin Sovjetik.<sup>6</sup> Për momentin gjërat nuk dukeshin edhe aq keq dhe dukej se jugosllavët ishin të vendosur të mos hynin në orbitën sovjetike, që për Hoxhën ishte konstantja e politikës së tij të jashtme dhe që do të përcaktonte edhe qëndrimin e tij ndaj çështjes së shqiptarëve në Jugosllavi dhe kërkesave të tyre në vitet që pasuan vdekjen e Titos.

Nga njëra anë, Hoxha ishte i interesuar që tensionet ndëretnike në Jugosllavi të ekzistonin, por në atë shkallë sa të dobësonin autoritetin e Beogradit dhe ta bënin më pak të rrezikshëm për të. Nga ana tjetër, ai nuk donte kurrsesi që përplasjet brenda federatës të degradonin deri në shkatërrimin e strukturës së ndërtuar nga Tito. Udhëheqësi i Tiranës argumentonte në ditarin e tij se shqiptarët të shpërndarë në republikat e Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi duhej të qëndronin të bashkuar për të fituar të drejta kushtetuese brenda suazave të federatës, pa u instrumentalizuar nga klani kroato-slloven apo ai serb.<sup>7</sup> Theksi te kujdesi dhe shmangia e mbështetjes së palëve që rivalizonin për pushtet brenda Jugosllavisë, tregonte, në të vërtetë qëllimin kryesor të Hoxhës: mbajtjen nën kontrollin e udhëheqjes komuniste shqiptare të lëvizjes nacionaliste të shqiptarëve në Jugosllavi dhe shndërrimin e saj në një instrument të përmbushjes së objektivit të politikës së jashtme të Tiranës, që ishte mbajtja në këmbë e strukturës federale. Aventurat, shkruante ai në ditarin e tij më 23 maj kur do t'i kthehej sërish çështjes së të ardhmes së Jugosllavisë pas vdekjes së Titos, do të shtypen dhe nuk kanë asnjë shpresë për fitore. Në këtë mënyrë, kreu i PPSH-së e bënte mjaft të qartë se zgjidhja e problemit të tyre do të realizohej vetëm në suazat e revolucionit brenda në Jugosllavi.<sup>8</sup>

Por nxitja e nacionalizmit në radhët e rinisë kosovare, me qëllim rritjen e ndikimit të Tiranës tek ajo, mund të shkaktonte një efekt *boomerang*. Në vend që të ndiqnin udhëzimet e Tiranës, aktivistët kosovarë mund të dilnin jashtë kontrollit të saj dhe të ndërmerrnin nisma që binin ndesh me interesat e udhëheqjes komuniste shqiptare. Kreu i Tiranës zyrtare parashikonte se në një rast të tillë, shumë nga shqiptarët e

<sup>6</sup> *Po aty*, f. 46-48.

<sup>7</sup> *Po aty*, f. 50-51.

<sup>8</sup> "Trashëgimia e Titos", *po aty*, f. 207-208.

Kosovës që do të përfshiheshin në ndonjë lëvizje antijugosllave do të arratiseshin në Shqipëri, gjë që do të bënte këtë të fundit të dukej si përgjegjëse për krizën. Hoxha do ta shprehte këtë frikë të tijën kur theksoi se, disa shqiptarë qoftë se ishin vegla serbe apo se “nuk e kuptonin mirë zhvillimin e ngjarjeve” mund të ndërmerrnin hapa që do t’u jepnin dorë klaneve serbe dhe kroate të armiqësonin *shqiptarët* me popujt e Jugosllavisë. Këtu, me “shqiptarë” kreu i PPSH-së kuptonte regjimin që ai drejtonte.<sup>9</sup>

Mesazhi i Enver Hoxhës ishte i qartë: regjimi i tij nuk do të mbështeste asnjë lëvizje irredentiste shqiptare në Kosovë dhe Jugosllavi. Ai nuk ishte partizan i revizionizmit të kufijve dhe e cilësonte ruajtjen e *status quo*-së ekzistuese në Jugosllavi si një *sine qua non* për Shqipërinë e tij. Dhe këtë ai donte që elitat e Beogradit ta kuptonin sa më shkoqur. E megjithatë, përpjekja për ta ushqyer nacionalizmin në radhët e shqiptarëve në Jugosllavi në funksion të interesave të veta e mbarste politikën e regjimit komunist shqiptar me kontradikta të shumta. Tensionet ndërmjet nevojës për të instrumentalizuar nacionalizmin ndër shqiptarët në Jugosllavi, dhe sidomos ata në Kosovë, dhe nevojës për të shmangur fillimin e një krize që mund të shkatërronte federatën ishin të mëdha.

Kjo ishte situata në mars të vitit 1981, kur filluan demonstratat studentore në Kosovë, në tri javët e para të të cilave Tirana qëndroi në heshtje. Ishte një heshtje kuptimplote, një heshtje që dëshmonte se udhëheqja komuniste shqiptare ishte duke kërkuar të kuptonte se çfarë po ndodhte, kush ishin aktorët e përfshirë, çfarë kërkonin ata dhe se si duhej të vepronin në një situatë të krijuar pa dijeninë e saj. Lëvizja e vitit 1981 i shfaqti zhveshur kontradiktat dhe rreziqet e kursit politik të Tiranës, e cila duhej të gjente një pikë pajtimi ndërmjet shtyllave të palëvizshme të konservatorizmit të politikës së saj të jashtme dhe lakueshmërisë së nacionalizmit funksional që ajo artikulonte

\*\*\*

Në fillim të prillit, Enver Hoxha ishte për pushime në Vlorë kur lajmet për ngjarjet në Kosovë filluan të bëhen alarmante. Më 3 prill, trupat e milicisë serbe shpërndanë me dhunë të skajshme demonstrata në Prishtinë e Podujevë, ku studentëve u ishin bashkuar edhe punëtorët

<sup>9</sup> “Panoramë e gjendjes ndërkombëtare”, *po aty*, f. 50-51.

kosovarë; kurse autoritetet jugosllave akuzuan demonstruesit si “nacionalistë shqiptarë” e “irredentistë” dhe shpallën gjendjen e shtetrrëthimit. Këto akuza dhe përkeqësimi i skajshëm i gjendjes në Kosovë e detyruan Enver Hoxhën t’i ndërpriste pushimet e tij në qytetin bregdetar jugor dhe të rikthehej me urgjencë po atë ditë në kryeqytet. Të njëjtën ditë, lideri komunist shqiptar u takua me dy bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë, Mehmet Shehun dhe Ramiz Alinë. Në vlerësimin që i bëri situatës së krijuar, Hoxha parashtoi se udhëheqja e PPSH-së duhej të analizonte ngjarjet në Kosovë duke vendosur në plan të parë implikimet që ato kishin për RPS të Shqipërisë. Sipas kreut komunist të Tiranës, armiqtë e Shqipërisë socialiste prisnin rastin ta likuidonin atë dhe ngjarjet e Kosovës mund të ishin pjesë e një skenari që kërkonin të përfshinin vendin në një situatë që t’u krijonte mundësi për të arritur qëllimet e tyre. Ndërhyrja e Shqipërisë për të kërkuar bashkimin e saj me Kosovën do të ofronte këtë shans dhe prandaj RPSSH-ja duhej të bënte kujdes dhe t’i ndihmonte demonstruesit kosovarë tërthorazi dhe jo në mënyrë të drejtpërdrejtë. Hoxha, u shpreh qartë në këtë takim se regjimi komunist i Tiranës duhej të përpiqej ta mbante të ndezur nacionalizmin shqiptar në radhët e rinisë kosovare pasi kjo do ta mbante këtë segment shoqëror të Kosovës të lidhur pas Shqipërisë.<sup>10</sup> Pra, ndërsa duhej bërë kujdes të mos provokoheshin jugosllavët, Sekretari i Parë i PPSH-së e konsideronte mbajtjen gjallë të nacionalizmit në Kosovë si një kapital të rëndësishëm politik në shërbim të interesave të tij.

Në mbledhjen e 5 prillit, Byroja Politike e PPSH-së, formalizoi vendimin që Hoxha kishte marrë me Alinë dhe Shehun dy ditë më parë për të botuar një artikull polemizues kundër udhëheqjes jugosllave në gazetën “Zëri i Popullit”. Sikundër do të shprehej edhe Hoxha në këtë mbledhje, në një kohë që Shqipëria ngre zërin edhe për vendet më të largëta, nuk mund të qëndrojë në heshtje për atë që ndodh në Kosovë. Artikulli, udhëzoi Hoxha do të mbështetej në një përzgjedhje të lajmeve të Agjencisë Telegrafike Jugosllave “Tanjug” dhe deklaratave të udhëheqësve jugosllavë, serbë e kosovarë në mënyrë që të goditnin fqinjët veriorë.<sup>11</sup> Për shkrimin e artikullit, Byroja Politike ngarkoi Ramiz

<sup>10</sup> *AQSH*, F. Enver Hoxha, 10/AP, Grupi III, Ndarja IV, D. 242, fl. 13-15, 17. Procesverbal i takimit të Enver Hoxhës, Mehmet Shehut dhe Ramiz Alisë lidhur me demonstratat në Kosovë, 3 prill 1981.

<sup>11</sup> *Po aty*, fl. 5-6. Shënime nga biseda e Enver Hoxhës në Byronë Politike të KQ të PPSH-së për ngjarjet në Kosovë, 5 prill 1981.

Alinë, detyrë që e kreu duke u mbështetur në një varg tezash të hartuara personalisht nga Enver Hoxha.<sup>12</sup>

Artikulli doli më 8 prill dhe do të ndiqej nga një artikull tjetër i botuar te “Zëri i popullit” më 23 të po të njëjtit muaj, i cili po njëlloj u mbështet mbi tezat e Enver Hoxhës.<sup>13</sup> Të shkruara me një ton të kujdesshëm, pajtues por njëkohësisht edhe të vendosur për të hedhur poshtë çfarëdo lidhje ndërmjet Tiranës dhe demonstratave që kishin shpërthyer qysh në mars në Kosovë, të dy artikujt e drejtonin gishtin te politikat ekonomike të Jugosllavisë si burimin e trazirave që po përfshinin krahinën autonome të banuar në shumicën dërrmuese nga shqiptarë.<sup>14</sup> Duke e përqendruar debatin tek infrastruktura ekonomike si çelësin shpjegues të dukurive politike në nivelin e superstrukturës, udhëheqësi komunist shqiptar përdorte analizën materialiste marksiste për të zhvlerësuar pretendimet jugosllave që mëtonin se prapa revoltave të studentëve kosovarë qëndronte propaganda ideologjike irredentiste e regjimit “stalinist shqiptar”. Ndërsa udhëheqja jugosllave akuzonte homologen e saj shqiptare për këto revolta, duke i dhënë kështu rol parësor faktorëve të jashtëm dhe subversionit ideologjik të nacionalizmit

<sup>12</sup> “Përleshje të reja të fuqishme në qytetet e Kosovës”, në E. Hoxha, *Ditar për çështjet ndërkombëtare (1980-1981) ...*, vëll. 13, f. 367-368; “Titistët sillen egër me demonstruesit kosovarë”, *po aty*, f. 369; “Byroja Politike diskuton ngjarjet në Kosovë”, *po aty*, f. 370; “Çfarë pohon dhe çfarë mohon zoti Dragosavac”, *po aty*, f. 371-379; *AQSH*, F. Enver Hoxha, 10/AP, Grupi III, Ndarja IV, D. 243, fl. 7-13. Shënime nga biseda e Enver Hoxhës në Byronë Politike të KQ të PPSH-së për ngjarjet në Kosovë, 5 prill 1981.

<sup>13</sup> “Arsyet e vërteta të gjendjes dhe të ngjarjeve të fundit në Jugosllavinë titiste”, në E. Hoxha, *Ditar për çështjet ndërkombëtare (1980-1981) ...*, vëll. 13, f. 384-409.

<sup>14</sup> “Pse u përdor dhuna policore dhe tanket kundër shqiptarëve në Kosovë?”, *Zëri i Popullit*, Tiranë, 8 prill 1981, f. 4. Ky artikull, do të ribotohej në gazetën “Bashkimi” më 9 prill, në gazetën “Drita dhe “Puna” më 10 prill dhe në gazetën “Zëri i rinisë” më 11 prill. Për më tepër, “Pse u përdor dhuna policore dhe tanket kundër shqiptarëve në Kosovë?”, *Bashkimi*, Tiranë, 9 prill 1981, f. 4; “Pse u përdor dhuna policore dhe tanket kundër shqiptarëve në Kosovë?”, *Drita*, Tiranë, 10 prill 1981, f. 3-4; “Pse u përdor dhuna policore dhe tanket kundër shqiptarëve në Kosovë?”, *Puna*, Tiranë, 10 prill 1981, f. 4; “Pse u përdor dhuna policore dhe tanket kundër shqiptarëve në Kosovë?”, *Zëri i rinisë*, Tiranë, 11 prill 1981, f. 4. “Kush e nxit armiqësinë midis popujve të Jugosllavisë”, *Zëri i popullit*, Tiranë, 23 prill 1981, f. 3-4. Ky artikull u ribotua në gazetën “Puna” më 24 prill dhe në gazetën “Zëri i rinisë” më 25 prill. Për më shumë, shih “Kush e nxit armiqësinë midis popujve të Jugosllavisë”, *Puna*, Tiranë, 23 prill 1981, f. 3-4; “Kush e nxit armiqësinë midis popujve të Jugosllavisë”, *Zëri i rinisë*, Tiranë, 23 prill 1981, f. 3-4.

të ushqyer nga autoritetet e Tiranës, këto të fundit e drejtonin gishtin nga politikat e Beogradit, duke e shndërruar problemin e demonstratave që shpërthyen në Prishtinë në një rezultat të sistemit ekonomik dhe politik të Jugosllavisë. Dhe këtu, nëpërmjet shtypit shqiptar, Hoxha e fuste debatin në orbitën e parapëlqyer të tij: në kritikën ndaj modelit jugosllav të “vetëadministrimit”, të cilin udhëheqësi komunist shqiptar e kishte etiketuar si antimarksist dhe kapitalist qysh në vitet ’50.

Ishte varfëria, produkt i diskriminimit ekonomik, ajo që i shtyn kosovarët të ngrihen në protesta, theksonin artikujt e “Zërit të popullit”. Ndryshe nga sa pretendonin teoricienët jugosllavë se Jugosllavia ishte një shtet që mbështetej mbi barazinë e njëjësive administrative që e përbënin atë, realiteti ishte i mbushur me pabarazi të thella dhe diskriminime që në vend t’i sheshonin, i thellonin ato. Të ardhurat për frymë në Kosovë ishin gjashhtë herë më të ulëta se në Slloveni, republika më e begatë e Jugosllavisë, 3.5 herë më të ulëta se në Kroaci, e 2.5 herë më të ulëta se në Serbi. Investimet në Kosovë, vinte në dukje organi i shtypit të PPSH-së, ishin 43% poshtë mesatares jugosllave, ndërsa rritja ekonomike në krahinën autonome shqiptare ishte disa herë më e ulët se në republikat e pasura të Federatës Jugosllave. Pasuritë e Kosovës shfrytëzoheshin dhe shkonin në tregjet europiane. Por kush përfitonte nga këto pasuri? Këtu krijohet një konflikt ndërmjet praktikës së vetadministrimit jugosllav dhe përvetësimit të pasurive të Kosovës nga qendra jashtë saj. Për rrjedhim, Kosova vuante nga papunësia shumë e lartë dhe emigracioni masiv, plagë këto të gjendjes shumë të vështirë ekonomike dhe mungesës së shpresës për një jetë më të mirë në vendin e tyre. Kjo ishte rrënja e pakënaqësive që cytën demonstratat e marsit dhe prillit të vitit 1981.

Në thelb të problemeve të Kosovës, vinte në dukje një artikull tjetër i “Zërit të popullit”, i botuar më 17 shtator të vitit 1981, ishte statusi i shqiptarëve si shtetas të dorës së dytë. Varfërimi i Kosovës dhe pozita e saj si një periferi ekonomike të republikave të pasura dhe të zhvilluara të federatës lidhej pazgjydhshëmrisht me statusin e shqiptarëve si shtetas të dorës së dytë. Për rrjedhim në Jugosllavi ndodhte një shtypje me karakter kombëtar, ku hierarkitë klasore ishin shndërruar në hierarki kombëtare. Fakti që udhëheqja jugosllave nuk pranonte afirmimin kombëtar të shqiptarëve dhe krijimin prej tyre të një republike ishte tregues i qartë se ajo nuk kishte për synim që t’i shkëpuste shqiptarët nga statusi i tyre



inferior.<sup>15</sup> Kjo bëhej edhe më e qartë po të merret parasysh se ndërsa Beogradi ndihmonte farkëtimin e një kombi maqedonas, këtë nuk e lejonte për shqiptarët që numerikisht ishin të barabartë me të parët.<sup>16</sup> Pra, problemi nuk ishte kërkesa e *ligjshme* e shqiptarëve për republikë të tyre brenda suazave jugosllave, por *padrejtësitë* të krijuara në Jugosllavi kundrejt tyre.

Zgjidhja e kësaj gjendjeje? Shndërrimi i Kosovës në republikë. Statusi i republikës do të shkëpuste Kosovën nga varësia koloniale e saj prej Republikës së Serbisë dhe republikave të tjera të pasura të Federatës së Jugosllavisë. Në këtë mënyrë, shtypi shqiptar i dërgonte mesazhe pozitive protestuesve kosovarë, duke i treguar atyre se Tirana zyrtare i mbështeste ata. E megjithatë, qëllimi i shtypit shqiptar nuk ishte t'i dërgonte mesazhe vetëm audiencës kosovare por edhe udhëheqjes jugosllave. Kësaj të fundit, regjimi komunist i Tiranës jo vetëm se i bënte të ditur se ai nuk kishte gisht në këto lëvizje, por edhe se kupola e PPSH-së nuk kishte asnjë qëllim irredentist kundrejt Jugosllavisë. Madje, shtypi do të ripohonte se shqiptarët do të luftonin përkrah popujve të Jugosllavisë në rast se ajo sulmohej nga socialimperialistët sovjetikë, deklarata këto që Tirana i bënte për të treguar përkushtimin e saj për të ruajtur strukturën jugosllave të pasluftës.<sup>17</sup>

Jugosllavët, nga ana tjetër, ishin të vetëdijshëm për rëndësinë që ata kishin për mbrojtjen e Shqipërisë nga një sulm i mundshëm nga forcat e Traktatit të Varshavës, mesazh që e bënë publik dhe me të cilin debatoi edhe “Zëri i popullit”. Edhe pse nuk e hodhën poshtë pretendimin e jugosllavëve, duke i dhënë atyre të drejtë, pala shqiptare nxitoi t'i kujtonte homologëve të saj jugosllavë se edhe Shqipëria ishte mbrojtëse e federatës nga krahu jugor i saj pasi nuk i hapte dyert investimeve të huaja – që do të përktheheshin në influencë ekstraballkanike në këtë pjesë të

<sup>15</sup> “Kërkesa “Kosova – republikë” nuk mund të shuhet as me dhunë, as me teorizime boshe”, *Zëri i popullit*, Tiranë, 12 shtator 1981, f. 3.

<sup>16</sup> “Kërkesa për t'i njohur Kosovës statusin e Republikës është e drejtë”, *Zëri i popullit*, Tiranë, 17 maj 1981, f. 2, 4. Ky artikull u botua po më 17 maj në gazetën “Bashkimi” dhe “Drita”. Për më tepër, “Kërkesa për t'i njohur Kosovës statusin e Republikës është e drejtë”, *Bashkimi*, Tiranë, 17 maj 1981, f. 2-4; “Kërkesa për t'i njohur Kosovës statusin e Republikës është e drejtë”, *Drita*, Tiranë, 17 maj 1981, f. 2-4.

<sup>17</sup> “Kërkesa për t'i njohur Kosovës statusin e Republikës është e drejtë ...”, f. 3.

siujdhesës, prani ushtarake dhe kërcënim për sovranitetin e Jugosllavisë, madje të krejt Ballkanit dhe Europës.<sup>18</sup>

Ndërkaq, duke pasqyruar frikën që kishte udhëheqja komuniste shqiptare nga një sulm i mundshëm ushtarak preventiv të Jugosllavisë mbi Shqipërinë, goditje kjo që mund të synonte lëvizjen e Hoxhës nga pushteti dhe ndryshimin e kursit politik që ndiqte deri në atë kohë Tirana, shtypi shqiptar i kujtonte fqinjët verior se Traktati i Varshavës përfaqësonte armikun kryesor për të dy vendet. Madje, organi i shtypit të PPSH-së nuk kurseu edhe shantazhet kur ngrinte pyetjen se si mund të pretendonte Beogradi, që shqiptarët e Jugosllavisë të kthenin pushkën ndaj Shqipërisë kur ata do të ndiqnin shembullin e saj për të mbrojtur Jugosllavinë.<sup>19</sup> Pra, ndërsa nga njëra anë ofronte degën e ullirit, Tirana i lëshonte Beogradit një kërcënim të fshehtë mbi rëndësinë që udhëheqja komuniste shqiptare luante për mbrojtjen e strukturës jugosllave. Ndërsa refuzonte se nuk kishte dorë në revoltat e vitit 1981, nga ana tjetër, Tirana rrihte gjoksin mbi ndikimin e saj te shqiptarët që jetonin në Jugosllavi, në mënyrë që të rriste rëndësinë e saj në sytë e udhëheqjes jugosllave.

Njëkohësisht, “Zëri i popullit” ritheksoi vendosmërinë e udhëheqjes së PPSH-së për ruajtjen e *status quo*-së së kufijve ndërkombëtarë duke argumentuar se nuk kishte asnjë dokument ku Shqipëria të bënte rivendikime territoriale ndaj Jugosllavisë. Madje, që të qetësonte Athinën dhe të shmangte një aleancë antishqiptare greko-jugosllave, shtypi shqiptar i dërgoi sinjale edhe Athinës, kur bënte me dije se regjimi komunist nuk kërkonte rishikimin e rendit ekzistues ndërkombëtar në rajon dhe nacionalizmi i tij nuk ishte irredentist.<sup>20</sup> Fitimi i statusit të republikës për Kosovën, vijonin artikujt e “Zërit të popullit”, ishte një çështje e brendshme e Jugosllavisë dhe e shqiptarëve që jetonin aty.<sup>21</sup>

Mesazhin e mësipërm, gazetat “Zëri i popullit” dhe “Bashkimi” – dy organet kryesore të shtypit komunist shqiptar nëpërmjet të cilave udhëheqja e regjimit të Tiranës bënte botërisht të ditur qëndrimin e saj – e dërgonin edhe në mënyrë të tërthortë, por gjithsesi mjaft efektive, duke vendosur pjesën më të madhe të artikujve mbi Kosovën në faqen katër të tyre, që i kushtohej çështjeve ndërkombëtare. Kështu, raportet dhe

<sup>18</sup> Po aty.

<sup>19</sup> Po aty.

<sup>20</sup> “Jugosllavia titiste, e sëmura e Ballkanit, nxit armiqësinë shqiptaro-greke”, *Zëri i popullit*, Tiranë, 11 qershor 1981, f. 4.

<sup>21</sup> “Kërkesa për t’i njohur Kosovës statusin e Republikës është e drejtë ...”, f. 3.

komentet mbi ngjarjet në Kosovë vendoseshin përbri reportazheve dhe njoftimeve mbi luftën antiimperialiste të popujve të Lindjes së Mesme dhe asaj të Largët, Amerikës Qendrore dhe Afrikës. Ndarja e së njëjtës hapësirë për zhvillimet në Kosovë me ato në Palestinë, Kamboxhia, Guatemalë apo Honduras në periodikët e saj tregonte qartë se autoritetet e Tiranës nuk i cilësonin demonstratat e vitit 1981 në krahinën autonome juglindore të Jugosllavisë si një problem të brendshëm por të jashtëm.

Si pjesë e gjuhës së dyfishtë që kërkonte të dërgonte mesazhe mbështetëse dhe qetësuese dy palëve të përfshira në konflikt, shtypi komunist bënte të ditur se nuk mund të pajtohej me trajtimin që Beogradi i bënte shqiptarëve dhe këshillonte uljen e gjakrave, maturi e kujdes. E detyruar të ecte mes Silës dhe Kabilës, kupola e regjimit komunist shqiptar gjente ekuilibrin e vështirë duke e kalibruar gjuhën e saj në atë mënyrë që t'i dërgonte sinjalin e duhur secilës palë dhe duke u kufizuar të këshillat dhe sugjerimet. Teksa deklaronte se Shqipëria nuk kishte për të ndërhyrë në çështjet e brendshme të Jugosllavisë, shtypi i Tiranës zyrtare theksonte se nuk mund të linte pa ngritur zërin për padrejtësitë që u bëheshin vëllezërve të tyre shqiptarë në Kosovë.<sup>22</sup> Ndërsa vinte në dukje se forcimi i Jugosllavisë ishte në interes të Shqipërisë, udhëheqja komuniste theksonte se ajo nuk pranonte që kjo të bëhej në kurriz të shqiptarëve.<sup>23</sup> Se si Tirana do t'i imponohej Beogradit për të mbrojtur të drejtat e shqiptarëve në Jugosllavi, dhe sidomos ata të Kosovës, kjo mbetej e paqartë. Në fakt, deklarata të tilla nuk mbartnin ndonjë përmbajtje reale dhe përgjithësisht ishin eufemizma për efekt propagandistik dhe konsum në Kosovë. Udhëheqja e PPSH-së donte t'i dëshmonte demonstruesve shqiptarë në Kosovë se ajo i mbështeste, edhe pse kjo mbështetje ishte vetëm me fjalë, pasi regjimi komunist shqiptar ishte njëkohësisht i interesuar të qetësonte jugosllavët.

Një luftë fjalësh filloi midis Tiranës dhe Beogradit. Nga njëra anë, pala jugosllave e mohonte diskriminimin e shqiptarëve në Jugosllavi si një problem sistemik dhe i interpretonte ngjarjet që kishin përfshirë Kosovën si rezultat të shovinizmit shqiptar të nxitur nga udhëheqja komuniste shqiptare. Prapa dyerve të mbyllura të mbledhjeve të Byrosë Politike, Hoxha e pranonte se shpërthimi i demonstratave të vitit 1981

<sup>22</sup> “Pse u përdor dhuna policore dhe tanket kundër shqiptarëve në Kosovë? ...”, f. 4; “Kush e nxit armiqësinë midis popujve të Jugosllavisë ...”, f. 3-4.

<sup>23</sup> “Kërkesa për t'i njohur Kosovës statusin e Republikës është e drejtë ...”, f. 3.

ishin edhe pasojë e politikës së regjimit komunist shqiptar, i cili kishte shfrytëzuar bashkëpunimin kulturor ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, të nisur qysh në fund të viteve '60, për të mbajtur të gjallë ndjenjën kombëtare në radhët e rinisë kosovare. E megjithatë, shtypi shqiptar pretendonte të kundërtën.<sup>24</sup> Gazetat shqiptare argumentonin se mëtimet e udhëheqjes jugosllave identifikonin në mënyrë të qëllimshme Tiranën si përgjegjëse, në mënyrë që të shmangnin vëmendjen nga burimi kryesor i pakënaqësive që kishin përfshirë popullsinë kosovare. Në mbështetje të tezave të tyre, autoritetet shqiptare përdorën përgjatë gjithë pranverës, verës dhe vjeshtës së vitit 1981 edhe shtypin e huaj, si atë suedez, zviceran, danez, francez, austriak, meksikan, grek, turk dhe sidomos atë amerikan, gjermanoperëndimor dhe italian, ku nuk ishin të pakta mediet që i shpjegonin ngjarjet në Kosovë në mënyrë të ngjashme me regjimin komunist shqiptar.

Nga ana tjetër, asnjë organ shtypi në bllokun socialist nuk kishte shkruar për demonstratat e Kosovës dhe shtypjen e tyre me dhunë të skajshme nga organet policore dhe ushtarake jugosllave. Një gjë e tillë nuk mund t'i shpëtonte Enver Hoxhës, i cili e kishte shumë të qartë se pavarësisht lirisë relative që kishte media në vendet e Traktatit të Varshavës, në asnjë rast shtypi nuk do të sfidonte politikën e regjimeve të tipit sovjetik.<sup>25</sup> Në një reflektim të gjatë që mbajti në ditarin e tij më 22 maj të vitit 1981, diktatori shqiptar e përqendroi vëmendjen e tij te sovjetikët dhe bullgarët. Sipas Hoxhës, udhëheqja e Moskës dhe ajo e Sofjes, ose nuk mbanin anë në konflikt në mënyrë që të nxinin konfliktin shqiptaro-jugosllav e të përfitonin prej tij, ose sepse ato ishin të lidhura dhe mbështetnin në heshtje elementë të caktuar në Beograd.<sup>26</sup>

<sup>24</sup> *AQSH*, F. Enver Hoxha, 10/AP, Grupi III, Ndarja IV, D. 243, fl. 8. Shënime nga biseda e Enver Hoxhës në Byronë Politike të KQ të PPSH-së për ngjarjet në Kosovë, 5 prill 1981.

<sup>25</sup> Edhe pse e vjetër si analizë, studimi i Gianna Salvini-it mbi shtypin në vendet socialiste dhe raportet e pushtetit politik dhe gazetarëve, vijon të ketë vlerë për të kuptuar lirinë ose mungesën e saj në ligjërimin mediatic në regjimet e tipit sovjetik të Evropës Lindore. Për më tepër, shih Gianna Salvini, "La stampa nei paesi socialisti", *L'est*, 1, Milano: 1971, f. 104-112.

<sup>26</sup> "Duhet të punojmë që opinion publik të jetë në favor të çështjes së Kosovës", në E. Hoxha, *Ditar për çështjet ndërkombëtare (1980-1981)* ..., vëll. 13, f. 467-479. Më konkretisht mbi shtypin sovjetik dhe bullgar, shih *po aty*, f. 478-479.

Në fillimi të qershorit, Hoxha dhe shtypi shqiptar e drejtuan gishtin hapur drejt klanit serb si kolona e pestë prosovjetike në Jugosllavi.<sup>27</sup> Në të vërtetë, gjatë majit të vitit 1981, fillon një ndryshim i rëndësishëm në ligjërimin e regjimit komunist shqiptar. Si do të thoshte edhe Enver Hoxha në mbledhjen e Byrosë Politike të datës 13 maj të vitit 1981 të mbajtur mbi qëndrimin publik të PPSH-së ndaj zhvillimeve në Kosovës, situata në Jugosllavi “nga koha në kohë ka evoluar”.<sup>28</sup> Ndryshimi i situatave, për të cilat fliste Hoxha, e kishin bërë më të qartë për diktatorin komunist se cili ishte rreziku afatgjatë dhe më i madh për të, gjë që do të pasqyrohej edhe në gjuhën e përdorur në shtypin shqiptar. Edhe pse akuzat ndaj titizmit dhe sistemit të vetadministrimit si burim i problemeve në Kosovë mbetën konstante e këtij diskursi, rëndësia e tyre filloi të humbasë. Nga ky moment, në fokus të udhëheqjes së PPSH-së vendoset klani serb.

Demonstratat në Kosovë treguan qartë krisjet që ekzistonin brenda udhëheqjes kolegjiale jugosllave dhe brishtësinë e strukturës federative; sikundër shfaqti qartë se klani serb ishte më i vendosuri kundër kërkesave të shqiptarëve, i cili ecte paralelisht me vendosmërinë e eksponentëve të shquar të këtij grupimi për të rivlerësuar pozicionin e serbëve brenda suazave të Jugosllavisë titiste. Nacionalizmi serb në rritje, rishfaqti për udhëheqjen komuniste shqiptare fantazmat dhe frikën e së shkuarës. E bashkë me fantazmat e së shkuarës regjimi komunist shqiptar nisi të huazonte nga e shkuara edhe repertorin terminologjik për të zhvilluar debatin e tij me ata që Tirana zyrtare identifikoi si armiqtë kryesorë të saj. Nga maji i vitit 1981, termat kryesorë në ligjërimin e shtypit komunist shqiptar janë ata të “serbomëdhenjve” dhe “socialimperialistëve sovjetikë”, që nisin identifikohen me politikat pansllave të Rusisë cariste.

Nëse gjatë prillit artikujt e botuar në shtypin shqiptar e preknin problemin e shpalljes së Kosovës republikë vetëm brenda tekstit dhe mes rreshtash, duke nisur nga maji, regjimi komunist shqiptar nis e kërkon

<sup>27</sup> AQSH, F. Enver Hoxha, 10/AP, Grupi III, Ndarja IV, D. 246, fl. 3-5. Bisedë e Enver Hoxhës me Ramiz Alinë mbi përgatitjen e një artikulli polemizues historiko-teorik kundër pretendimeve jugosllave mbi Kosovën, 4 qershor 1981; “Mbi bashkëpunimin e fshehtë sovjeto-serbomadhi”, në E. Hoxha, *Ditar për çështjet ndërkombëtare (1980-1981)* ..., vëll. 13, f. 493-495; “Ngjarjet e Kosovës dhe bashkëpunimi i fshehtë sovjeto-serbomadhi”, *Zëri i popullit*, Tiranë, 5 qershor 1981, f. 4.

<sup>28</sup> AQSH, F. PPSH, 14/AP-Organet Udhëheqëse (më tej: OU), V. 1981, D. 117, fl. 40. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike, më 13 maj 1981.

këtë gjë hapur duke e bërë të qartë në qëndrimin e tij edhe në titujt e artikujve të botuar në organin e vetë shtypit, “Zëri i popullit”. Tanimë, në vend të gjuhës së dyfishtë, e cila kërkonte të qetësonte njëkohësisht Beogradin dhe të ruante ndikimin mbi demonstruesit kosovarë, udhëheqja komuniste shqiptare filloi të ishte më e drejtpërdrejtë e të përdorte një gjuhë që dërgonte gjithnjë e më pak mesazhe të shumëfishta. Paralelisht me artikullimin më të hapur të nevojës për shndërrimin e Kosovës në republikën e shtatë jugosllave, shtypi shqiptar i mëshoi gjithnjë e më shumë tezës serbomadhe si burimi kryesor i protestave në krahinën autonome me shumicë dërrmuese shqiptare. Tanimë rrënja e pakënaqësive të shqiptarëve në Kosovë identifikohet gjithnjë e më pak me sistemin e vetadministrimit, e gjithnjë e më shumë me shovinizmin serb.

Siç do të theksonte edhe artikulli i tretë i rëndësishëm redaksional që botoi “Zëri i popullit” mbi çështjen e Kosovës më 17 maj të vitit 1981, fakti që Beogradi lejoi krijimin e një republike maqedonase dhe malazeze por ndaloi rreptësisht atë të Kosovës, tregon se në kryeqytetin e Jugosllavisë dominonte mendësia dhe politika e borgjezisë serbomadhe. Deklaratën e Petar Stambolić-it, njëri nga përfaqësuesit kryesorë të klanit serb në Lidhjen Komuniste të Jugosllavisë, se nuk kishte një etni të pastër shqiptare në Kosovë, udhëheqja komuniste e Tiranës i shikonte si zgjatime gjenealogjike të programeve shoviniste të Vaso Čubrilović-it. Këto deklarata, theksonte artikulli i “Zërit të popullit”, i cili ishte konceptuar nga vetë Hoxha dhe ishte diskutuar në Byronë Politike të PPSH-së, ishin për nga natyra fashiste dhe krijonin etni të dorës së parë dhe ato të dorës së dytë, në shfrytëzues dhe të shfrytëzuar.<sup>29</sup> Ishin “serbomëdhenjtë” ata që, sipas një artikulli tjetër të botuar më 12 shtator të vitit 1981 nga “Zëri i popullit”, pengonin kthimin e Kosovës në republikë.<sup>30</sup> Tashmë nuk ishin as titistët dhe as klani kroato-sllloven, që

<sup>29</sup> “Kërkesa për t’i njohur Kosovës statusin e Republikës është e drejtë”, *Zëri i popullit*, Tiranë, 17 maj 1981, f. 2, 4; Mbi konceptimin e këtij artikulli nga Enver Hoxha, shih: “Si t’i çminojmë e si t’i shpartallojmë akuzat antishqiptare të titistëve lidhur me ngjarjet në Kosovë”, në E. Hoxha, *Ditar për çështjet ndërkombëtare (1980-1981)* ..., vëll. 13, f. 424-438; Mbi diskutimin e këtij artikulli në Byronë Politike të PPSH-së, *AQSH*, F. 14/AP (OU), V. 1981, D. 117, fl. 1-50. Artikull e pocesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike, më 13 maj 1981: Mbi diskutimin dhe miratimin e artikullit “Kërkesa për t’i njohur Kosovës statusin e Republikës është e drejtë”.

<sup>30</sup> “Kërkesa “Kosova – republikë” nuk mund të shuhet as me dhunë, as me teorizime boshe”, *Zëri i popullit*, Tiranë, 12 shtator 1981, f. 3-4.

ishite i lidhur me kapitalin perëndimor dhe ShBA-në, ata që përfaqësonin armikun e shqiptarëve në të dyja anët e kufirit politik shqiptaro-jugosllav, por ishte klani serb.

Nga maji, regjimi komunist shqiptar e zhvendosi ideologjikisht edhe interpretimin e tij mbi rrënjën e protestave në Kosovë. Nga shpjegimet material-ekonomike, artikulli i 17 majit argumenton të drejtën e shqiptarëve të Kosovës për të pasur një republikë të tyre në suazat e Jugosllavisë mbi bazën e argumentit primordialist të unitetit të kulturës popullore, gjuhës, historisë, letërsisë dhe muzikës së përbashkët. Në këtë artikull, koncepti marksist i tregut të unifikuar kombëtar, si baza mbi të cilën ngrihej kombi u zhduk krejtësisht dhe në vend të tij, Hoxha dhe lidershpi komunist shqiptar nisën të përdornin një ligjërim që mbështetej mbi parimet e Herderit dhe të Fishtës. Uniteti shpirtëror dhe kulturor i këpuste lidhëzat e shumta të këmishës së forcës që impononin ekonomia dhe politika. Në një demonstrim force, artikulli i 17 majit i kujtonte udhëheqjes jugosllave se shqiptarët ishin komb i vetëm, një realitet i përbërë prej 5 milion banorësh të vendosur në një territor kompakt.<sup>31</sup>

Një pohim i tillë nga ana e autoriteteve shqiptare nuk ishte i rastësishëm. Beogradi kishte akuzuar Shqipërinë komuniste se kishte shndërruar në një armë lidhjet kulturore të vendosura pas vitit 1968 midis Shqipërisë dhe Kosovës për të përhapur ide irredentiste dhe shoviniste. Duke drejtuar gishtin nga shovinizmi borgjez serb, Tirana legjitimonte politikën e saj kulturore ndërmjet shqiptarëve nga të dy anët e kufirit jo si shprehje e nacionalizmit romantik por si një e drejtë që nuk binte ndesh me frymën e socializmit. Beogradi hidhte poshtë kërkesat e shqiptarëve në Kosovë duke përdorur në mbështetje të tij marksizmin. Autoritetet e larta jugosllave i etiketonin kërkesat e nacionalistëve shqiptarë si “mite të së kaluarës” e “idhuj të së kaluarës” të frymëzuara nga nacionalizmin romantik. Duke i identifikuar këto kërkesa si antisocialiste, elita jugosllave synonte të deligjitimonte kërkesat e shqiptarëve në Kosovë. Në kundërpërgjigje, shtypi komunist shqiptar i hidhte poshtë këto pretendime pasi ato sipas tij synonin privimin e shqiptarëve nga e drejta e vetëvendosjes, e mbështetur mbi idenë e kombit, për t’u organizuar në një republikë.

Jashtë këtij debati nuk do të mund të qëndronin historianët. Stefanaq Pollo, drejtori i Institutit të Historisë në Tiranë, ishte një ndër studiuesit

<sup>31</sup> “Kërkesa për t’i njohur Kosovës statusin e Republikës është e drejtë ...”, f. 3-4.

shqiptarë që kërkoi të pajtonte marksizmin e deklaruar të udhëheqjes së PPSH-së me ligjërimin e saj nacionalist të tipit herderian. Në debat me një artikull të botuar në gazetën “Le Monde” – të cilën “Zëri i popullit” e quante si një zëdhënëse të shovinizmit jugosllav<sup>32</sup> – që pohonte se shqiptarët kishin kolonizuar Kosovën, Pollo argumentonte se këto teza ishin ndërtuar nga historiografia borgjeze serbe e shek. XIX, teza këto që ajo jugosllave vijonte t’i riciklonte. Si pjesë e një akademie të një vendi josocialist, ku socializmi ishte një cipë e hollë që nuk e fshihte dot ideologjinë borgjeze që udhëhiqte elitën politike jugosllave, edhe historiografia e këtij vendi nuk udhëhiqej nga marksizmi.

Pollo e hidhte poshtë tezën e kolonizimit të Kosovës dhe argumentonte në mënyrë aspak marksiste se shqiptarët e këtij rajoni kishin formuar tiparet e një kombësie kompakte qysh në shek. XIV – kohë kjo kur në hapësirën shqiptare as nuk mund të bëhej fjalë zhvillim kapitalist. Zgjerimi i shtetit mesjetar të Nemanjiçëve vendosi përballë klasën feudale serbe mbi masën e gjerë autoktone shqiptare. Pollo e vendoste dominimin serb të Kosovës dhe programin e “Serbisë së madhe” në një kontekst më të gjerë kur e krahasonte atë me programin nazist të “Lebensraumit”, që kërkonte pushtimin gjerman të krejt hapësirës së Europës Balltike nisur nga sundimi shumëshekullor i fshatarësisë sllave prej aristokracisë prusiane. E njëjta dukuri kishte ndodhur edhe në territoret moderne jugosllave, ku pjesë të tëra të rajoneve të populluara nga popullsia sllave dominoheshin nga aristokracia dhe borgjezia urbane gjermane.<sup>33</sup> Mesazhi i këtij prezentizmi historik ishte i qartë: shqiptarët në Kosovë po përjetonin në fundin e shek. XX një rikthim në histori, një padrejtësi që i kthente ata mbrapsht në kohën kur dikur popullsia e rajonit sundohej nga kasta drejtuese e një shteti të huaj. Si në mbretërinë e Nemanjiçëve në Mesjetë, ashtu edhe në mbretërinë e Karagjorgjeviçëve apo në Jugosllavinë titiste në shek. XX, shumica autoktone shqiptare po shtypej nga një shtet i huaj, duke e bërë këtë riciklim të historisë një plagë të shekullit ku parimi i vetëvendosjes ishte postulati kryesor për organizimin e rendit ndërkombëtar.

Historianët nuk ishin të vetmit intelektualë shqiptarë që u përfshinë në betejën mbi mitet e nacionalizmit shqiptar e serb. Shkrimtari i shquar

<sup>32</sup> “Kërkesa “Kosova – republikë” nuk mund të shuhet as me dhunë, as me teorizime boshe”, *Zëri i popullit*, Tiranë, 12 shtator 1981, f. 3.

<sup>33</sup> Stefanaq Pollo, “Mite përballë realitetit”, *Zëri i Popullit*, Tiranë, 28 qershor 1981, 4.



Ismail Kadare u bë pjesë e këtij debati. Në artikullin “Kultura shqiptare në shënjestër të shovinizmit serbomadh”, të cilën Hoxha e kishte lexuar paraprakisht dhe shprehu pëlqimin për përmbajtjen e tij,<sup>34</sup> Kadare replikoi me ideologët jugosllavë, që e konsideronin nacionalizmin shqiptar në Kosovë si të nxitur nga Tirana dhe e vishnin me petkun reaksionar të “romantizmit kombëtar” dhe “idealeve të vdekura”, si një alternativë anakronike, të tejkaluar, një ide subversive që krijonte kushtet për shkatërrimin e Jugosllavisë. Njëlloj si edhe Pollo, Kadareja, që diskutoi mitet e historisë, mori në shqyrtim idhujtarinë e tejkaluar kombëtare duke e ballafaquar atë me idhujtarinë e re jugosllave, që i shërbente interesave të Beogradit në dëm të interesave të veçanta, por që në të vërtetë ishte idhujtaria e nacionalizmit serb që kërkonte të heshte atë shqiptar. Si do të mundeshin intelektualët shqiptarë të Kosovës të këmbenin historinë mijëravjeçare të kombit të tyre me atë 40-vjeçare të Jugosllavisë socialiste? – pyeste Kadare. Njëlloj si edhe të gjithë nacionalistët, shkrimtari i shquar shqiptar e esencializonte kulturën shqiptare dhe e shikonte atë të shprehur te një strukturë mendore dhe ndijore specifikisht shqiptare që shpalosej në jetën shpirtërore të kujtdo shqiptari. Kështu, kombi shqiptar shihej dhe vlerësohej si një entitet ahistorik që kishte mbijetuar për mijëra vite dhe që kishte ruajtur të paprekur thelbin e tij.<sup>35</sup>

Artikulimi gjithnjë e më i hapur i dimensionit kulturor të kombit e shndërroi kulturën dhe historinë shqiptare ashtu si e përpunonte dhe përhapte regjimi komunist i Tiranës, në një mollë sherri mes këtij të fundit dhe Beogradit. Në kushtet kur përdorimi i trashëgimisë kulturore i shërbente farkëtimit të një vetëdije kombëtare në radhët e shqiptarëve të Jugosllavisë dhe orientimin e besnikërisë së tyre kah Tiranës, gjë që përshkallëzonte edhe më tej prirjet centrifugale në Jugosllavinë post-titiste, një grup politikanësh të lartë jugosllavë, sidomos serbë, propozuan ndërprerjen e marrëdhënieve kulturore ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, bashkëpunim ky që shihej në zanafillë të trazirave të vitit 1981 dhe ngjalljes së idhujve të nacionalizmit. Me udhëzimin personal të Enver

<sup>34</sup> AQSH, F. Enver Hoxha, 10/AP, Grupi III, Ndarja IV, D. 246, fl. 2. Bisedë e Enver Hoxhës me Ramiz Alinë mbi përgatitjen e një artikulli polemizues historiko-teorik kundër pretendimeve jugosllave mbi Kosovën, 4 qershor 1981.

<sup>35</sup> Ismail Kadare, “Kultura shqiptare në shënjestër të shovinizmit serbomadh” në *Mbi ngjarjet në Kosovë: artikuj të “Zërit të popullit” dhe organeve të tjera të shtypit*, Tiranë: 8 Nëntori, 1981, f. 87-97.

Hoxhës, shtypi shqiptar nisi një ofensivë kundër këtij propozimi.<sup>36</sup> Si pjesë e kësaj fushate, një grup dijetarësh dhe profesorësh shqiptarë, ndër të cilët fizikanët Sotir Kuneshka dhe Viron Kola, matematikani Aleko Minga, mjeku Pëllumb Bitri, historiani Stefanaq Pollo, gjuhëtari Androkli Kostallari e të tjerë studiues, akuzuan në një artikull të botuar më 26 maj të vitit 1981 në gazetën “Zëri i popullit” se prapa masave obskurantiste që propozonin segmente të caktuara në Beograd fshihej dora e klanit serbomadh. Këto qarqe shoviniste synonin të pengonin zhvillimin kulturor të shqiptarëve në Jugosllavi sepse dija si forcë emancipuese shndërrohej në një instrument zhvillimi të tyre kombëtar.<sup>37</sup>

Përpos dijetarëve dhe akademikëve, pjesë e polemikës së përgjithshme u bë edhe Kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve, Dritëro Agolli. Në një artikull të botuar në “Zërin e popullit”, më datë 7 qershor, në replikë me gazetën serbe “Politika”, të cilën shtypi shqiptar e cilësonte si zëdhënëse të klanit serbomadh, Agolli kujtonte se Tito e kishte miratuar personalisht vendosjen e bashkëpunimit kulturor midis Shqipërisë dhe Kosovës. Nëse ky bashkëpunim do të nxiste irredentizmin, vijonte Agolli, Tito nuk do ta kishte miratuar. Edhe pse Agolli nuk vononte të theksonte se Tito gjithashtu ishte antishqiptar, argumenti i tij nënkuptonte se nuk ishin mbështetësit e udhëheqësit të vdekur jugosllav, por armiqtë e këtij të fundit ata që donin t’i jepnin fund shkëmbimeve kulturore ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës.<sup>38</sup> E këta armiq nuk ishin askush tjetër por serbomëdhenjtë.

Përgjatë verës dhe vjeshtës së vitit 1981, si ideja e pavarësisë së Kosovës ashtu edhe akuzat ndaj klanit serbomadh do të bëheshin më të hapura dhe do të ishin politikat kulturore jugosllave ato që autoritetet e Tiranës do të cilësonin si antisocialiste. Përprjekjet e udhëheqjes jugosllave për ndërtimin e identitetit kulturor të jugosllavizmit, regjimi komunist i Hoxhës i emërtoi si një veshje e re për politikat e vjetra të Mbretit Aleksandër për të serbizuar gjithë popujt e Jugosllavisë. Elitat e Federatës po dëshmonin se vijonin të frymëzoheshin nga të njëjtat parime

<sup>36</sup> AQSH, F. Enver Hoxha, 10/AP, Grupi III, Ndarja IV, D. 244, fl. 1-2. Procesverbal i një takimi të kryer në zyrën e Enver Hoxhës mes Sekretarit të Parë të PPSH-së dhe Ramiz Alisë, 13 maj 1981.

<sup>37</sup> “Zëri i shkencës dhe era e shovinizmit”, në *Mbi ngjarjet në Kosovë: ...*, f. 84-86.

<sup>38</sup> Dritëro Agolli, “Kush është kundër bashkëpunimit kulturor midis Shqipërisë e Jugosllavisë?”, në *Mbi ngjarjet në Kosovë ...*, f. 109.

si ato të borgjezisë së vjetër serbe.<sup>39</sup> Jugosllavizmi nuk ishte asgjë tjetër vetëm se një emër i ri për të zbatuar politikën e kahershme serbe për asimilimin e shqiptarëve.<sup>40</sup> Ndërsa akuzonin shqiptarët për nacionalizëm romantik dhe shovinizëm, ishin vetë serbët, malazezët dhe maqedonasit ata që po vepronin nën ideologjinë e shovinizmit borgjez dhe ishin ata antisocialistët. E thënë ndryshe, në Beograd ishin ulur këmbëkryq fashistët serbë, të cilët regjimi i Titos jo vetëm që nuk i kishte asgjësuar por i kishte integruar ata dhe ideologjinë e tyre brenda strukturës së pushtetit në krye të të cilit ndodhej vetë ai.

Më 9 qershor, në artikullin redaksional “Piemonti i mirëfilltë, “Piemonti” jugosllav dhe “Piemonti shqiptaromadh”, i cili ishte po ashtu i mbështetur mbi tezat e Enver Hoxhës,<sup>41</sup> “Zëri i popullit” e ritheksoi këtë qëndrim të regjimit komunist shqiptar. Shqipëria socialiste, theksonte ky artikull, nuk kërkon ndryshim kufijsh, por një trajtim të barabartë të shqiptarëve të cilët shteti jugosllav i konsideron si “racë inferiore”. Në thelb të këtij racizmi qëndronte vetë programi i “Serbisë së madhe”, që kishte ushqyer politikën serbe qysh prej shek. XIX e që reminishencat e saj po shpaloseshin qartazi në Kosovë në vitin 1981. Projekti nacionalist serb ishte në thelb imperialist dhe synonte bashkimin e sllavëve të Jugut nën egjidhën hegjemone serbe. Vetëm socializmi, i cili asgjësonte bazën e shfrytëzimit të shumicës nga pakica, mund të emanciponte popujt e Jugosllavisë dhe ta shndërronte këtë të fundit në një shtet ku të gjithë grupet të ishin të barabartë. Problemi ishte, vijonte artikulli, se Tito dhe klika e tij nuk ishin komunistë dhe klani që udhëhiqte Jugosllavinë e tradhtoi socializmin, duke i lejuar idesë serbomadhe të mbijetonte në formën e centralizimit burokratik serb. Mohimi i të drejtave të shqiptarëve në Kosovë ishte shprehja më e mirë e mbijetesës së shovinizmit borgjez serb në suazat e një shteti të vetëshpallur socialist,

---

<sup>39</sup> “Shkolla shqipe në Kosovë në goditjen e shovinizmit serbomadh”, *Mësuesi*, Tiranë, 16 shtator 1981, f. 4.

<sup>40</sup> “Kërkesa “Kosova – republikë” nuk mund të shuhet as me dhunë, as me teorizime boshe”, *Zëri i popullit*, Tiranë, 12 shtator 1981, 3.

<sup>41</sup> *AQSH*, F. Enver Hoxha, 10/AP, Grupi III, Ndarja IV, D. 246, fl. 1-8. Bisedë e Enver Hoxhës me Ramiz Alinë mbi përgatitjen e një artikulli polemizues historiko-teorik kundër pretendimeve jugosllave mbi Kosovën, 4 qershor 1981.

ku socializmi ishte një fasadë për të fshehur pabarazitë tipike të kapitalizmit.<sup>42</sup>

Më 12 shtator të vitit 1981, “Zëri i popullit” botoi një tjetër artikull ku ndërrsa pohonte me forcë të drejtën e shqiptarëve të Kosovës për të jetuar në një republikë të tyre brenda suazave të Jugosllavisë, mëtonte se Beogradi kërkonte asimilimin e shqiptarëve brenda masës sllave.<sup>43</sup> A mos vallë po përgatiten serbomëdhenjtë t’i heqin Kosovës të drejtën të flasë shqip? – pyeste Dritëro Agolli në artikullin e tij të 7 qershorit.<sup>44</sup> Censurimi i teksteve si dhe shkarkimet në stafin pedagogjik shqiptar në Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi, argumentonte një artikull i botuar po në shtator në gazetën “Mësuesi”, ishin pjesë e atyre politikave që synonin shndërrimin e rjetit arsimor në zonat shqiptare nga një instrument për ruajtjen e vetëdijes kombëtare në një platformë për të asimiluar dhe sllavizuar shqiptarët nën parullën e jugosllavizmit. Këto reagime, vinte në dukje ky artikull, nuk ishin gjë tjetër veçse histori serbomadhe të trashëguara nga e kaluara.<sup>45</sup>

Sipas Ismail Kadarese klima e ashpër e krijuar në Jugosllavi ishte rezultat i fushatës antishqiptare të krijuar nga shovinizmi serb i cili kishte vënë në shënjestër kulturën shqiptare. Këtë “gjueti shtrigash”, sikurse e konsideronte Kadare fushatën e ndërmarrë në atë kohë në Jugosllavi kundër lidhjeve kulturore ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, shovenët serbë e bënë me qëllim që të diskreditonin dhe të përndiqnin intelektualët kosovarë që ishin bërë flamurtarë të lëvizjes për emancipimin e shqiptarëve në Jugosllavi.<sup>46</sup> Në Tiranë, goditjen sistematike që organet jugosllave po i bënë institucioneve kulturore dhe arsimore në zonat shqiptare e interpretonin si një përpjekje për të goditur ndikimin që Shqipëria komuniste kishte mundur të ndërtonte në radhët e inteligjencies shqiptare gjatë thujse një dekade e gjysmë, qysh nga viti 1968. Objektivi kryesor i Beogradit, në këndvështrimin e krerëve të

<sup>42</sup> “Piemonti i mirëfilltë, “Piemonti” jugosllav dhe “Piemonti shqiptaromadh”, *Zëri i popullit*, Tiranë, 9 qershor 1981, f. 4.

<sup>43</sup> “Kërkesa “Kosova – republikë” nuk mund të shuhet as me dhunë, as me teorizime boshe”, *Zëri i popullit*, Tiranë, 12 shtator 1981, f. 3.

<sup>44</sup> D. Agolli, “Kush është kundër bashkëpunimit kulturor midis Shqipërisë e Jugosllavisë? ...”, f. 109.

<sup>45</sup> “Shkolla shqipe në Kosovë në goditjen e shovinizmit serbomadh”, *Mësuesi*, Tiranë, 16 shtator 1981, f. 4.

<sup>46</sup> I. Kadare, “Kultura shqiptare në shënjestër të shovinizmit serbomadh...”, f. 94.

PPSh-së, ishte të këpuste lidhjet sinkronike dhe diakronike me Shqipërinë.

Përse “serbomëdhenjtë” vihen në qendër të vëmendjes së regjimit komunist shqiptar? Përse Tirana zyrtare nisi të konsideronte klanin serb si një rrezik eminent të sajin? Përse udhëheqja e PPSH-së filloi të shqetësohej për politikën asimiluese që autoritetet e Beogradit po kërkonin të zbatonin kundrejt popullsisë shqiptare në Jugosllavi? Përse kultivimi i identitetit kombëtar ndër shqiptarët e Jugosllavisë mori një rëndësi të madhe për Enver Hoxhën në vitin 1981? Përse regjimi komunist shqiptar filloi të shprehte hapur qëndrimin e tij pro shpalljes së Kosovës si republikë e shtatë e Jugosllavisë? Për t’i dhënë përgjigje këtyre pyetjeve, duhet bërë lidhja ndërmjet fjalëve kyç “serbomëdhenj” dhe “socialimperialistët sovjetikë”.

\*\*\*

Nëse pas vdekjes së Titos, në vitin 1980, udhëheqësi komunist shqiptar mendonte se grupimi serb në Jugosllavi do të ndiqte një kurs politik që do të mbante Moskën larg kufijve jugosllavë, ngjarjet në Kosovë një vit më vonë e shtynë kreun e PPSH-së të ndryshonte mendim. Heshtja e shtypit sovjetik dhe e gjithë vendeve të Bllokut Socialist mbi ngjarjet në Kosovë, e shtynë Enver Hoxhën dhe rrethin e tij të ngushtë të rivlerësonin raportet ndërmjet klanit serb dhe Kremlinit. Në një artikull të 5 qershorit 1981, gazeta “Zëri i popullit” theksoi se ndërsa Washington-i u mundua të qëndronte i paanshëm dhe i konsideroi trazirat në Kosovë si një problem të brendshëm të Jugosllavisë që nuk prekte interesat amerikane, sovjetikët nuk shpreheshin aspak lidhur me këtë çështje. Sipas organit të shtypit të PPSH-së, Kremlini po shfrytëzonte demonstratat në Kosovë për të nxitur tensionet ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë që të dobësonin të dy fqinjët ballkanikë dhe, nëpërmjet dorës serbe të përmbushte ambiciet e kahershme sovjetike në këtë pjesë të Europës.<sup>47</sup>

Duke përsëritur tezat që Hoxha kishte artikuluar qysh në maj dhe mbështetur në shkrimet e udhëheqësit komunist shqiptar, “Zëri i popullit” mëtoi në korrik të vitit 1981 se Moska synonte ta ushqente konfliktin shqiptaro-jugosllav. Acarimi i marrëdhënieve midis Tiranës dhe Beogradit, argumentonte artikulli, do t’i krijonte mundësi sovjetikëve të

<sup>47</sup> “Ngjarjet e Kosovës dhe bashkëpunimi i fshehtë sovjetico-serbomadhi ...”, f. 4.

ndërhynin në punët e brendshme të dy vendeve të Adriatikut Lindor. Kali i Trojës në Jugosllavi ishte grupi burokratik serb, që do të kërkonte mbështetjen sovjetike për të imponuar mbi klanin kroato-slloven hegjemoninë e tij në federatë. Përpos rritjes së bashkëpunimit ushtarak midis të dy shteteve, i cili lehtësohej nga dominimi i ushtrisë jugosllave nga klani serb, shtypi shqiptar identifikoi rritjen e investimeve sovjetike në Jugosllavinë post-titiste, si në formën e kredive ashtu edhe në financimin e zgjerimit të aparatit industrial. Jo rastësisht këto investime ishin përqendruar në Serbi dhe Maqedoni, pasi ato synonin të forconin ekonomikisht klanin serb që ai të vendoste hegjemoninë e tij në Jugosllavi.<sup>48</sup> Dhe ishte pikërisht në këto dy republika ku regjimi komunist i Tiranës identifikonte edhe zellin më të madh shovinist antishqiptar.<sup>49</sup>

Vendosja në fokus të Moskës së dy republikave ortodokse tregonte qartë se Kremli i ishte kthyer politikave pansllaviste të carizmit dhe rrjeti i aleancave po ndiqte vijat e vjetra qytetërimore dhe fetare. Nga vëzhgimet e tyre, Hoxha dhe udhëheqja komuniste shqiptare perceptonte se koniunktura ndërkombëtare në fund të shek. XX po përvijohet dhe madje po i nënshtrohet historisë 1600-vjeçare të linjës së Teodozit. Tensionet dhe aleancat e jashtme të grupimeve politike që drejtonin Jugosllavinë ndiqnin këtë vijë të rëndësishme ndarëse. Regjimi komunist shqiptar interpretonte dhe shpjegonte tensionet si dhe dinamikat e investimeve në Jugosllavinë post-titiste brenda kornizave të Luftës së Ftohtë dhe ku nevojat politike të zgjerimit të zonave të influencës nënshtonin faktorët ekonomikë, të cilët konsideroheshin thjesht si mjete të objektivave gjeostrategjike. Ndërsa rrjeti i aleancave udhëhiqej nga afiniteti fetar dhe kulturor, gjë që përforconte edhe më tej orientimet politike me karakter qytetërimor.

Ajo që shqetësonte më shumë Hoxhën nuk ishte në vetvete nacionalizmi serb, apo edhe ai grek. Ishte sinergjia që mund të krijohet

<sup>48</sup>“Marrëdhëniet ekonomike midis Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik dhe komploti ruso-serbomadh”, *Zëri i popullit*, Tiranë, 12 korrik 1981, f.4; Mbi rritjen e bashkëpunimit ushtarak, shih: “Çfarë kërkojnë flotat ushtarake të superfuqive në portet jugosllave”, *Zëri i popullit*, Tiranë, 1 korrik 1981, f. 4; “Delegacion ushtarak i socialimperialistëve sovjetik në Jugosllavi,” *Zëri i popullit*, Tiranë, 7 korrik 1981, f. 4.

<sup>49</sup> “Shtypja dhe mohimi i kulturës kombëtare të shqiptarëve të Jugosllavisë nuk mund të mbulohen me shpifje kundër RPS të Shqipërisë”, *Zëri i popullit*, Tiranë, 19 shtator 1981, f. 4.

mes programeve për hegjemoni rajonale të nacionalizmave ballkanas dhe projekteve për dominim botëror të superfuqive ajo që trembte më shumë diktatorin komunist shqiptar. Sipas tij, Fuqitë e Mëdha që kërkonin të rrisnin ndikimin e tyre në Ballkan gjenin aleatë lokalë të zellshëm për të plotësuar ambiciet e tyre përmes mbështetjes nga jashtë. Dhe më shumë se kushdo, këtë zell e kishin nacionalistët e siujdhesës, për të cilët mbështetja nga jashtë ishte e nevojshme për të përmbushur objektivat e programeve të kahershme të tyre. Kështu, përmes aktorëve lokalë që vepronin si masha të tyre, Fuqitë e Mëdha apo superfuqitë e shndërronin gadishullin në një fushë beteje. Sikundër do të shkruante në ditarin e tij politik më 1 nëntor të vitit 1981, superfuqitë kërkonin të ngjallnin pasionet nacionaliste në Ballkan për të rritur hegjemoninë e tyre në siujdhesë.<sup>50</sup>

Shqiptarët në Jugosllavi sidomos ata në Kosovë, marrin një rëndësi shumë të madhe për regjimin komunist. Nga viti 1981, Hoxha filloi t'i shohë ata si një forcë kundërbalancuese ndaj nacionalizmit serb dhe shndërrimit të Serbisë në një vatër të përçimit të interesave sovjetike. Ligjërimi i regjimit komunist shqiptar ishte dinamik dhe i përgjigjej zhvillimeve politike dhe ideologjike që ndodhnin jashtë vendit. Në koniunkturën e rëndësishme historike të vitit 1981, nacionalizmi mori një rëndësi të veçantë në politikën e jashtme të regjimit komunist shqiptar. Kriza e vitit 1981 e bëri Hoxhën të kuptonte plotësisht forcën e nacionalizmit serb dhe aleancën e tij me Moskën, të cilën, sikundër e tregova edhe më sipër, në vitin 1980 kreu i PPSH-së e kishte nënvlerësuar. Frika nga nacionalizmit serb dhe mbështetja që ai mund të gjente te Bashkimi Sovjetik ka qenë një faktor shumë i rëndësishëm në shndërrimin e shqiptarëve të Jugosllavisë në kapital politik për Tiranën zyrtare të kohës. Kjo është edhe arsyeja pse udhëheqja komuniste shqiptare nisi të shprehë shqetësimin ndaj asaj që ajo e cilësonte si politikë asimiluese të Beogradit që synonte të shkrinte shqiptarët me masën sllave.<sup>51</sup>

Identiteti kombëtar i shqiptarëve në Jugosllavi dhe bashkë me të edhe kultura e ideja e një uniteti kombëtar që kapërcente kufijtë politikë e ideologjikë kishte për Tiranën rëndësi kapitale në kalkulimet e saj për një

<sup>50</sup> Enver Hoxha, *Dy popuj miq*, Tiranë: 8 Nëntori, 1985, f. 341-342.

<sup>51</sup> "Kërkesa "Kosova – republikë" nuk mund të shuhet as me dhunë, as me teorizime boshe ...", f. 3.

botë ku energjia e ideologjive universaliste po tronditej nga lokalizmat nacionalistë – ose të paktën kjo ishte panorama në vendet socialiste të Europës Lindore ku solidariteti socialist nuk ia kishte dalë të fashiste nacionalizmin. Nga Polonia në Jugosllavi situata tregonte qartë se identitetet kombëtare ishin më të forta se çdo aleancë ideologjike internacionaliste. Edhe pse zor të mendohet se Hoxha dhe rrethi i tij i ngushtë ishin naivë sa të besonin se Beogradi do të lejonte shndërrimin e Kosovës në republikë, interesat e regjimit komunist shqiptar ishin tjetërkund. Një rëndësi shumë të madhe për udhëheqjen e Tiranës kishte mobilizimi i shqiptarëve në Jugosllavi me kërkesa të qarta politike me karakter kombëtar. Kjo, sa do t'i mbante lidhur pas Tiranës aq edhe do t'i bënte ata një element tampon mes Shqipërisë dhe Serbisë. Në të njëjtën kohë, organizimi politik i shqiptarëve në Jugosllavi rreth një platforme ideologjike kombëtare do t'i kthente ata në një forcë që do të dobësonte faktorin serb brenda strukturës federative. Balancimi i klanit serb do të ulte aftësinë e tij për të përçuar interesat sovjetike në Jugosllavi e më gjerë në rajon.

Kështu, shqiptarët do të ndihmonin mbizotërimin e klanit kroato-sllloven në dëm të hegjemonisë serbe dhe do të neutralizonin kështu nacionalizmin serb. Në momentin kur Hoxha mendoi se klani serb po forconte lidhjet me Bashkimin Sovjetik, ai filloi të mbështeste klanin kroato-sllloven. Vijimi i dominimit të Jugosllavisë nga ky grupim do ta mbante në këmbë federatën, shembja e të cilës do t'i hapte rrugën simbiozës serbo-sovjetike dhe më pas ushtrimit të nacionalizmit ekstrem serb. Një skenar i tillë do të hapte një rrugë të panjohur sa për shqiptarët në Kosovë – sidomos ku asnjë nga kancelaritë perëndimore nuk kishte dalë në mbështetje të hapur të tyre – aq edhe për vetë Shqipërinë. Ishte aleanca e mundshme serbo-sovjetike ajo që shqetësonte udhëheqësin komunist dhe që ai konsideronte si rrezik ekzistencial për pushtetin dhe Shqipërinë e tij. Për këtë arsye, retorika nacionaliste e regjimit komunist shqiptar në vitin 1981, shoqërohej me praninë e kudondodhur të “Tjetrit” të nevojshëm. Ligjërimi nacionalist i udhëheqjes së PPSH-së, kishte në qendër të tij sa shqiptarët e Jugosllavisë dhe sidomos ata të Kosovës, aq edhe “serbomëdhenjtë” dhe socialimperialistët sovjetikë mbështetës të pansllavizmit – dy fraza kyç këto në ligjërimin e Tiranës zyrtare nga maji i vitit 1981. Kultivimi i nacionalizmit ndër shqiptarët e Jugosllavisë ishte pjesë e përpjekjeve të Enver Hoxhës për të sulmuar klanin serb. Me këtë



lëvizje udhëheqësi komunist shqiptar synonte të gjente mbështetje te klani kroat.

Në aleancë me klanin kroat dhe atë slloven, shqiptarët e Kosovës dhe ata të Jugosllavisë, të udhëhequr nga një program i qartë nacionalist, mund të arrinin të organizoheshin në një republikë të shtatë brenda strukturës federative. Për këtë arsye, ligjërimi i regjimit të Tiranës i dha aq rëndësi gjeografisë dhe kompaktësisë së shqiptarëve në Ballkan dhe bashkimit të tyre në Jugosllavi nën një ombrellë të vetme. Ndarja e shqiptarëve në tri republika të ndryshme sllave ishte një gërshtëri për t'i dobësuar ata përballë etnive dhe republikave të tjera sllave. Ky ribashkim do t'i bënte ata një faktor të rëndësishëm në Jugosllavi dhe do të vinte në vend një padrejtësi historike.<sup>52</sup> Territorialiteti i Kosovës dhe organizimi i shqiptarëve në Jugosllavi në një strukturë kompakte, i bënte ata aktorë strategjikë si në raportet ndëretnike brenda Jugosllavisë ashtu edhe ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë – ekzistencën e së cilës regjimi komunist i Tiranës e konsideronte si thelbësore për mbijetesën e tij. Edhe në kulmin e polemikave ndërmjet Beogradit dhe Tiranës, shtypi komunist shqiptar nuk do të reshtte së theksuari se ruajtja e Jugosllavisë ishte në interes të Shqipërisë dhe se kjo e fundit kishte për qëllim ruajtjen e stabilitetit të fqinjët të saj verior dhe jo shkatërrimin e tij. Regjimi komunist shqiptar u përpoq të vinte në dukje se nacionalizmi i tij nuk ishte agresiv dhe irredentist, se ai nuk synonte të ndryshonte kufijtë ndërkombëtarë, por t'i ruante ata.

### *S u m m a r y*

#### THE 1981 REVOLTS IN KOSOVA AND THE NATIONALISM OF THE TIRANA'S COMMUNIST REGIME - AN ANALYSIS OF THE ALBANIAN PRESS

This article discusses the fluidity of the Albanian communist's nationalist discourse. It takes as a case study the reaction of the ALP's leadership to the demonstrations that occurred in Kosova in 1981 and uses the Albanian press as

<sup>52</sup> “Kërkesa për t'i njohur Kosovës statusin e Republikës është e drejtë ...”, f. 3-4; “Kërkesa “Kosova – republikë” nuk mund të shuhet as me dhunë, as me teorizime boshe ...”, f. 3.

a lens to explore the transformation of its nationalist discourse. Combining press with Enver Hoxha's diary and archival resources from the ALP collection, enables a fuller understanding of the gap between public declarations and the calculations behind the stage. A meticulous analysis of the articles the Albanian communist press published on the events of 1981 in Kosova, reveals the contradictions in which Tirana's communist regime was caught. From the perspective of *realpolitik*, the ALP's leadership considered Yugoslavia as a buffer zone between its borders and the countries of the Warsaw Treaty. Yugoslavia kept the Soviet armies away from the Albanian borders, thus preventing any Moscow's attempt to intervene and change the ALP's leadership. On the other hand, the Albanian communist top echelons, could not abandon publicly the Kosovar protesters. Ultimately, the course of events in Kosova and the reaction of the Serbian leadership gradually solved the tension between *realpolitik* and nationalism. Indeed, Hoxha did distinguish the Yugoslav leadership from the Serbian one. While the Croatians and Slovenians held a moderate stance toward the events of 1981 in Kosova, the Serbians used an inflammatory nationalist language against both the Albanian Kosovars and the ALP's leadership. Observing the international reaction to the demonstrations in Kosova, Hoxha concluded that Moscow was backing the Serbian leadership because Kremlin considered Serbian nationalism as a tool for extending its influence in the western part of the Balkans. After the Albanian communist leadership reached this conclusion, Tirana regime's press took a decisive turn and openly supported the claims of the Kosovar Albanians for transforming Kosova into the seventh republic of Yugoslavia. However, the ALP's leadership did not embrace an irredentist agenda. In Hoxha's calculations, the transformation of Kosova into a republic would dilute the power of the Serbians within the federation, thus hampering the growth of Soviet influence around his neighborhood. Hoxha's goal indeed, was the preservation of Yugoslavia, a *sine qua non*, according to him, for the survival of his power.